



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

Programi i Lëndës
Drejtimi: Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

**TITULLI I LËNDËS: KONSERVIMI I OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË
KULTURORE**

Pedagogu: PhD.c Edlira Çaushti dhe PhD.c. Erinda Ndreçka
Ngarkesa: 4 ECTS (45 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: me zgjedhje
Programi i studimit: Bachelor
Viti/Semestri: I/II

EKSTRAKT

Qëllimi kryesor i programit është diskutimi i përmbajtjes dhe konceptit të konservimit në objektet e Trashëgimisë Kulturore. Vëmendje kryesore do të kushtohet konservimit parandalues të objekteve në muzeume apo fonde, rëndësisë që ka ky konservim dhe domosdoshmerisë të përfuturit të aftësive për të monitoruar objektet e koleksioneve muzeore. Aspekte të tjera lidhen me ngritjen e aftësive për të analizuar objektet, vëzhguar nevojat e tyre lidhur me mjedisin ku ndodhen. Aspekt i rëndësishëm është edhe aftësimi i studentëve në analizimin dhe dokumentimin e artefakteve në koleksionet muzeore të përbëra nga materiale të ndryshme (organike dhe inorganike) apo fragmente objektësh të dala nga gërmimet arkeologjike. Kujdesi në levizje, paketimi, dhe sistemimi i objekteve në fonde do të jete nje leksion demonstrativ dhe praktik, ku studentet do të performojnë vetë ne aplikimin e metodologjive bashkekohore.

Një pjesë e këtij cikli leksionesh i kushtohet njohjes së metodave analitike eksperimentale dhe aplikimit të tyre praktik në objektet e trashëgimisë kulturore. Njohja e studenteve me ekzaminimet eksperimentale dhe verifikimin e kushteve optimale për konservimin e objekteve të TK do të jete themelore gjatë këtij kursi.

TEMAT

LEKSION 1. Konservimi dhe aspektet e ndryshme të tij. (parandalues, investigues dhe stabilizues)

LEKSION 2. Ndërgjegjësimi për rendësinë e konservimit parandalues dhe roli i tij në muzetë sot. Aftësia për të vlerësuar nevojat e objektit në koleksionet muzeale apo fonde dhe metodat e ndryshme të kontrolleve mjedisore.

LEKSION 3. Aspekte të dokumentimit të artefakteve të TK.

LEKSION 4. Aftësia e krijimit të një sistemi monitorimi dhe sistemi për kontrollin e gjendjes së konservimit (krijimi i një raporti të gjendjes së konservimit).

LEKSION 5. Siguria nëpër muzeume, manaxhimi i koleksioneve. Instruksione të aplikueshme në shumicën e rrethanave aktuale.

LEKSION 6. Levizja e objekteve në fonde dhe aftësi për të menaxhuar ato në mënyrë të përshtatshme.

LEKSION 7. Rreziku që i kanoset objekteve si dhe manaxhimi i tij në muze.

LEKSION 8. Kujdesi, kontrolli dhe administrimi i manuskripteve në fonde.

LEKSION 9. Njohje me agjentet mjedisore dhe ndikimi i tyre në degradimin e objekteve të TK (ajri, lagështia, temperatura, oksigjenimi, rrezatimi dritor etj). Metoda praktike të monitorimit të faktoreve.

LEKSION 10. Aftësi për të kuptuar, analizuar dhe dokumentuar artefaktet e trashëgimisë materiale.

LEKSION 11. Materialet e ndryshme përbërëse të objekteve dhe artefakteve, teknika të realizimit dhe ndjeshmeritë e tyre.

LEKSION 12. Studimi i Artefakteve të përbëra nga materiale inorganike (qeramikat, qelqet, metalet) me anë të metodave të spektroskopisë së emisionit dhe absorbimit atomik.

LEKSION 13. Investigimi analitik me anë të strukturave bërthamore të artefakteve të realizuara nga materiale të përbëra, heterogjene, si dhe rrezatimi i tyre me anë të izotopeve gjurmues. Kushtet e ruajtjes së tyre.

LEKSION 14. Aplikimi i teknikave të aktivimit neutronik dhe Raman në studimin e artefaktet e përbëra nga materiale organike si pjesë delikate të koleksioneve muzeale. Kushtet optimale të ruajtjes së tyre.

LEKSION 15. Aftësi për të analizuar, dokumentuar dhe paketuar objekte si dhe depozitimi i tyre në fonde.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% pranishë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)
Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)
25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)
20 % e notës përfundimtare

KONTROLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri
40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

1. Culturale Heritage protection Handbook 4 (UNESCO) Disaster risk managment
<http://www.unesco.org/new/en/culture/themes/museums/movable-heritage-outreach-programme/cultural-heritage-protection-handbooks-in-local-languages>
2. Culturale Heritage protection Handbook 3 (UNESCO) Documentation of artifact's collections.
<http://unesdoc.unesco.org/images/0015/001514/151447e.pdf>
3. Culturale Heritage protection Handbook 5 (UNESCO) Handling of collections in storage
<http://unesdoc.unesco.org/images/0018/001879/187931e.pdf>
4. Culturale Heritage protection Handbook 2 (UNESCO) Care and handling of manuscripts
<http://unesdoc.unesco.org/images/0014/001484/148463e.pdf>
5. Culturale Héritage protection Handbook 1 (UNESCO) Security at museums <http://obs-traffic.museum/cultural-heritage-protection-handbook-security-museums>
6. Running a Museum (ICOM) A practical handbook.
<http://unesdoc.unesco.org/images/0014/001410/141067e.pdf>
7. Bradley A. Rodgers; The archaeologist's manual for conservation. A guide non toxic minimal intervention artefact stabilisation.
8. The effects of air pollution on Culture Heritage ; Wat, John ; Tidblad, Johan ; Kucera, Vladimir ; Hamilon, Ron. SPRINGER Editors.
9. Rodgers, Bradley A. and John O. Jensen. "The Electro/Sugar Conservation of a Waterlogged Wood-Iron Composite Artifact." (Unpublished Manuscript, East Carolina University, Program in Maritime History and Underwater Research) (1990): 1–18. [ECU-170]

- 10.** Starling, Katherine. "The Conservation of Wet Metal/Organic Composite Archaeological Artifacts at the Museum of London." ICOM Proceedings (Fremantle) (1987): 215–221. [ECU-206] Selwyn, L.S., D.A.
- 11.** Rennie-Bissaillon , and N.E. Binnie. "Metal Corrosion Rates in Aqueous Treatments for Waterlogged Wood-Metal Composites." Studies in Conservation Vol. 38 No. 3, 1993, pp. 180–197. [ECU-747]